

FTESË PËR OFERTË

Emri: Milieukontakt Shqipëri
Adresa: Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion,
 Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri
E-mail: office@milieukontakt.org
Afati i dorëzimit të ofertës: **26/09/2024**

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin “*Të Rinjtë për Ndryshimet KLIMAtike (RIKLIMA)*”, mbështetur nga Bashkia Tiranë, që synon nxitjen e një ndryshimi transformues në qëndrimet dhe sjelljet e të rinjve mbi ndryshimet klimatike dhe fuqizimi i tyre përmes promovimit të praktikave miqësore me mjedisin.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **26/09/2024**, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose në adresën postare Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Milieukontakt Shqipëri do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktin sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Emërtimi	Specifikim teknik	Njësia	Sasia	Cmim/ Njësi	Vlera Lekë
1.	Pushim kafeje dhe snacks	Kafe, çaj, Ujë mineral, kek, snack	persona	80		
	TOTAL					

Ofrimi i këtij shërbimi kërkohet për periudhën **Shtator-Tetor 2024**. Me Subjektin fitues do të lidhet një kontratë shërbimi.

Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Preferohen subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e Bashkisë Tiranë;
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email office@milieukontakt.org brenda datës **26/09/2024** ose në adresën postare Rr. 'Xhorxhi Martini', Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.
Nuk pranohen ofertat dorazi.
- 4) Pagesa e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit / Ekstraktin e QKB;
- 2) Ofertën financiare për produktin sipas tabelës më sipër.
- 3) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.